



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2019:169388

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05636195

C.nr.112/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË–Departamenti i Përgjithshëm, Dega në Gllgoc, me gjyqtarin Jeton Krasniqi dhe bashkëpunëtorin profesional Dardan Elshani, në çështjen juridike-kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, përfaqësuar me autorizim nga G.P, kundër të paditurit T.G nga Komuna e Gllgoc, të cilin e përfaqëson Bashkëshortja e tij S.G, me objekt kontesti rimbursimin e dëmit, me vlerë të objektit të kontestit në shumë prej 15,539.79€, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të çështjes të mbajtur më datë 11.04.2023, në të cilin ishin të pranishëm i autorizuari i paditëses dhe përfaqësuesja e të paditurit, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR, kërkesëpadija e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, dhe DETYROHET i padituri T.G nga Komuna e Gllgoc, që paditëses t’ia paguaj shumën prej 15,539.79 €, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 16.02.2008, me kamatë si për mjetet e deponuara në bankat e Kosovës pa destinim mbi një vit, duke filluar nga data 29.06.2015 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 77.69€ të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja me datë 29.06.2015, ka parashtruar padi në këtë gjykatë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri T.G nga Komuna e Gllgocit, që paditëses t’ia paguaj shumën prej 15,539.79€, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut, me kamatë ligjore duke filluar nga data e parashtrimin të padisë e deri në pagesën definitive. Paditësja në padi ka theksuar se i paditur me datë 16.02.2008 ka shkaktuar aksident trafiku me automjetin e tij Audi 89 me targa të regjistrimit... në Prishtinë ku si pasojë e këtij aksidenti, lëndime trupore ka pësuar familja S... nga Mitrovica. I padituri ka qenë i pa siguruar, respektivisht i kishte skaduar afati i periudhës së sigurimit në momentin e aksidentit. Në ndërkohë në këtë aksident familja S... ka bërë padi për kompensim dëmi ndaj paditësit në Gjykatën Themeore në Prishtinë e cila ka marr numrin C.nr.1265/09. Sipas Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, paditësja është e obliguar që këtë dëm t’ia kompensoj të dëmtuarit dhe të njëjtin të rimbursoj nga shkaktari i aksidentit – respektivisht nga i padituri si në rastin konkret. Gjykata Themelore në Prishtinë ka marrë vendim që të dëmtuarit në këtë aksident trafiku ti paguhet shpërblimi i dëmit në shumën prej 15,539.79 € dhe i cili është paguar me datë 26.03.2015.

Përmes parashtrës së datës 15.05.2019, paditësi e ka precizuar kërkesëpadinë e tij duke theksuar se të dëmtuarit në këtë aksident familja S... është kompensuar në shumën prej 31,264.00 €, familja G... në shumën prej 16,679.00 € dhe M... Sh.P.K në shumën prej 21,033.86 €, si dhe lënda për rentë që është duke u zhvilluar në këtë gjykatë me shenjën C.nr.108/15 në shumën prej 15,539.00 €.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc me aktgjykimin C.nr.108/15 të datës 06.08.2018, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke e detyruar të paditurin që paditëses në emër të regresimit të dëmit material dhe jo material t'u paguaj shumën e përgjithshme prej 15,539.79€. Duke vepruar sipas ankesës së palës së paditur, Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin Ac.nr.4701/19 të datës 02.03.2023, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurës ndërsa aktgjykimin e kësaj gjykate e ka prishur dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe vendosje. Në shqyrtimin kryesor të rigjykimit përfaqësuesi i paditëses ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj pasi që i padituri T.G ka shkaktuar aksident trafiku duke i shkaktuar dëm material dhe jo material të të paditurve-Familjës S... të cilët i kanë kompensuar sipas LSDA-së, përkatësisht nenit 18 dhe atë shumën prej 15,539.79 e cila shumë është llogaritur për rentën brenda periudhës së përcaktuar si në aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1265/09 i formës së prerë me datë 10.11.2014. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë kërkesëpadisë dhe deklarimeve në seancat gjyqësore duke propozuar që kërkesëpadia e saj të aprovohet.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për taksë gjyqësore për padi.

I padituri nuk ka paraqitur përgjigje në padi përkundër faktit se gjykata me aktvendimin C.nr. 104/2014 të datës 03.07.2018 i ka dërguar aktvendimin për përgjigje së bashku me padinë dhe provat e bashkangjitura padisë, ku në bazë të fletë kthesës vërtetohet se i njëjti e ka pranuar me datë 21.03.2019.

Në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare e autorizuar e të paditurit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklarimeve si nga seancat e kaluara, duke shtuar se nuk ka mundësi për ta paguar, lënda është vjetërsuar dhe është mbajtëse e familjes, andaj ka propozuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike-kontestimore, me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të autorizuarit të paditëses ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat siç janë: Raporti fillestar i aksidentit i dt. 16.02.2008 me nr...; raporti i hetuesit i datës 17.02.2008 në skicën e vendit të ngjarjes të datës së njëjtë; vërtetim mjekësor për vdekje data e të cilit nuk është i lexuar; certifikata e vdekjes me nr. rendor... dhe numër të referencës... të dt.27.02.2008; certifikata e martesës me nr... e dt. 26.02.2008; certifikata e lindjes me nr. rendor... lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Mitrovicë e dt. 26.02.2008; certifikata e lindjes me nr... lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Mitrovicë me dt.26.02.2008; certifikata e lindjes me nr. rendor... lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Vushtrri me dt.26.02.2008; certifikata familjare e lëshuar nga Drejtoria e administratës së përgjithshme në komunën e Mitrovicës me dt.26.02.2008 me nr...; Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë me shenjën C.nr... i dt.22.03.2011; ekspertiza financiare me shenjën C.nr.1265/09 e ekspertit A.B e dt.28.02.2011; Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr... i dt.10.11.2014; Revizioni i parashtruar nga paditësja me dt.10.12.2014; propozim për përmbarrim me shenjën P.nr... i dt.15.01.2015; prapsim i paditëses i dt.16.01.2015; ankesa e paditëses me shenjën PPP.nr... e dt. 18.03.2015, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-departamenti i përgjithshëm i dt. 26.02.2015; fletëpagesa e paditëses në llogari të të dëmtuarës, ekzekutuar përmes përmbarruesit privat E.M e dt. 26.03.2015; aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-

Dega në Glllogoc me shenjen P.nr... i plotfuqishëm me dt.19.06.2018; pajtim gjyqësor i arritur në këtë gjykatë me shenjen C.nr... i dt.08.08.2017 në mes të autorizuarit paditëses dhe të autorizuarës së të paditurit që ka të bëjë me shumën prej 21.033.86 euro në emër të kompensimit për dëmin material-automjetin e dëmtuar, materialin ndërtimor; aktgjykimi i kësaj Gjykate C.nr... i dt.16.06.2009; Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut me shenjen Ac... i dt.15.04.2010; Aktgjykim i kësaj gjykate me shenjen C.nr... i dt. 06.08.2019; fletlëshimi i dt. 06.10.2010 deri më 11.10.2010 lëshuar nga QKUK në Prishtinë; reparti i ortopedisë; Raporti mjekësor i Klinikës së radiologjisë në QKUK në Prishtinë i dt. 18.07.2019, raporti mjekësor i dt.16.09.2011, aktvendimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr... i dt.02.03.2023, si dhe shkresat e siguruar nga gjykata që kanë të bëjnë me lenden C.nr... siç janë: padia e dt. 28.07.2008 lidhur me regresin në shumën prej 21.033.86 euro; padi për kompensim dëmi të parashtruar nga sh.p.k “M...” kundër të të paditurës tani paditëses BKS në Prishtinë për kompensimin e dëmit material; aktgjykimi i gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë me shenjen II.C.nr... i dt.17.12.2008; aktgjykimi i Gjykatës Supreme me shenjen AE.nr... të dt.21.05.2012, aktvendimi i Gjykatës Ekonomike në Prishtinë E.nr... i dt.17.10.2012; njoftimi i bankës Ekonomike me nr... i dt.22.10.2012.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhmëri me njëra tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore-LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike - civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga provat e administruara gjykatës i rezultoi se i padituri më datë 16.02.2008, rreth orës 15:20 minuta, përderisa ishte duke qarkulluar me automjetin Audi, në Magjistralen Pejë Prishtinë në fshatin... Komuna e Drenasit, saktësisht përballë Supermarketit “T...”, duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit dhe me shenjë trafiku është e ndaluar tejkalimi i automjeteve, i njëjti kishte ndërmarr veprimin për tejkalimin e automjetit para tij pa u bindur mirë se një veprim të tillë mund ta bëjë në mënyrë të sigurt, kështu që me automjet kishte kaluar në shiritin e majtë të drejtimit të lëvizjes së tij dhe ishte ndeshur drejtpërdrejt me automjetin transportues “S...”. Me rastin e këtij aksidenti ngasësi(i padituri) i veturës Audi kishte pësuar lëndime të rënda trupore, kurse dy pasagjerët e tij (B.S dhe V.G) kishin vdekur në vendin e ngjarjes. Vetura që ka drejtuar i padituri T.G ka qenë e pasiguruar, respektivisht i kishte skaduar afati i periudhës së sigurimit në momentin e aksidentit.

Në bazë të aktgjykimit penal të kësaj Gjykate P.nr... i cili është bërë i formës së prerë me datë 19.06.2014, konstatohet se i padituri T.G është shpallur fajtor për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik dhe i njëjti është dënuar me dënim me burg.

Me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr... të datës 22.03.2011, i cili është bërë i ekzekutueshëm me datë 19.12.2014, vërtetohet se paditësve A.S, R.S, B.S dhe S.S.1 i është aprovuar si e bazuar padia lidhur me pagimin e rentës mujore kundër të paditurës Fondi i Garancisë së Kosovës për Sigurim të Detyruar, në shumën prej 5.545,68€ deri me datë 28.02.2011, kurse për periudhën nga 01.03.2011 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore nga 144.48€ në muaj, me kamatëvonesë ligjore 3.5 % nga data 22.03.2011 e deri në përmbushje definitive së bashku me shpenzimet procedurale në shumën prej 508€.

Sipas Ekspertizës nga lëmia e sigurimeve, aktuaristikes dhe financave të datës 28.02.2011, të punuar nga eksperti A.B, konstatohet se familjes së të ndjerit B.S nga Komuna e Mitrovicës si pasojë e vdekjes së tij në aksidentin e datës 16.02.2008, shuma e cila duhet paguar në emër të mbajtjes së humbur-rentës për periudhën 16.02.2008 deri në 28.02.2011 është 5,545.68€, për periudhën nga 01.03.2011 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, në shumë mujore prej 144,48€ e cila paguar në formë të menjëhershme arrin vlerën prej 20,918.00€. Ndërsa shuma e

gjithmbarshme e rentës për periudhën e kaluar dhe për periudhën e ardhshme të paguar në formë të menjëhershme-të kapitalizuar, arrin vlerën prej 26,463.68€.

Në bazë të propozimit për përmbarim të kreditorëve A... R... B... S..S.1 dhe S.S.2 nga Komuna e Mitrovicës, vërtetohet se të njëjtit propozimin e kanë parashtruar me datë 15.01.2015 të përmbaruesi privat E.M, përmes të cilit kanë kërkuar kompensimin në emër të rentës kundër debitorit Byroja Kosovare e Sigurimeve ish Fondi Garancisë së Kosovës në lartësi prej 5,545.68€, kurse nga data 01.03.2011 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore t'u paguaj nga 144.48€ në muaj me kamatë ligjore 3.5% e deri në pagesën definitive, duke përfshirë shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 508.00€. Propozimi për përmbarim tek përmbaruesi ka marrë numër P.nr... dhe është lejuar me datë 15.01.2015.

Në bazë të Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr... të datës 26.02.2015, gjykata gjeti se i është refuzuar si i pa bazuar prapësimi i debitorit Byroja Kosovare e Sigurimeve me Seli në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr... të datës 15.01.2015, të lejuar nga përmbaruesi privat E.M në Prishtinë.

Me leximin e prapësimit të datës 16.01.2015 vërtetohet se debitori BKS kishte kundërshtuar urdhrin e përmbaruesit privat E.M, P.nr... të datës 15.01.2015.

Me leximin e aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr... të dt. 26.02.2015, vërtetohet se prapësimi i debitorit BKS ishte refuzuar ndërsa urdhri i Përmbaruesit Privat P.nr... i datës 15.01.2015 kishte mbetur në fuqi.

Në bazë të fletëtransferit të datës 26.03.2015, me nr të referencës... vërtetohet se BKS-Fondi i lidhur me lëndën P.nr... ka paguar shumën prej 15,539.79€, pranë bankës... në llogarinë të përmbaruesit privat E.M.

Baza juridike e kërkesë padisë, që i padituri të jetë përgjegjës për Rimbursimin e dëmit paditësit, gjejnë mbështetje në dispozitat e Ligjit Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia me nr.04/L-018, e lidhur me dispozitat e nenit 262 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i datës 30 mars 1978 (i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raporteve detyrimore në mes të palëve), ku është përcaktuar se *“Kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*. Pra në këtë rast, kreditori është Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, ndërsa debitori është i padituri T.G nga Komuna e Drenasit.

E drejta e paditëses për të kërkuar rimbursimin ka mbështetje në nenin 18 të LSDA Nr.04/L-018, e cila i referohet dëmshpërblimit nga përdorimi i mjetit motorik të pa siguruar, ku në paragrafin 1 përcaktohet që: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësisë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”*. Paragrafi 4 i të njëjtës dispozitë përcakton që: *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*. Në këtë rast, personi përgjegjës është i padituri T.G, i cili si shkaktar i aksidentit të datës 16.02.2008 nuk kishte mbulesë siguruese.

Nga këto të cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi sepse nga të gjitha provat e administruara është vërtetuar fakti se shkaktari i aksidentit ka qenë i paditur i cili në momentin e aksidentit nuk ka pasur mbulesë siguruese, ndërsa të dëmtuar kanë qenë familja S... nga Mitrovica të cilët fillimisht dëmin material në emër të rentës e kanë realizuar në procedurë gjyqësore e pastaj tek përmbaruesi privat kundër BKS dhe atë në shumën prej 15,539.79 € për periudhën e përshkruar në aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr... të plotfuqishëm

me datë 10.11.2014, fakt që është vërtetuar edhe me fletëpagesën nga përmbaruesi Privat E.M të datës 26.03.2015, nr. P.nr... numër ky i cili përputhet me numrin e lëndës së përmbaruesit privat kur ka caktuar përmbarimin me urdhrin e datës 15.01.2015. Shumën e lartcekur të cilën BKS-ja i'a kishte paguar të dëmtuarve në të dëmit material përkatësisht për rentën, tani në këtë procedure duke u bazuar në nenin 18 par.4 të LSDA-së ka kërkuar që t'ia regresoj i padituri për arsyet e lartcekura, andaj gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke vërtetuar gjendjen e lartcekur faktike, obligoi të paditurin që paditëses t'ia paguajë shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 16.02.2008.

Për detyrimin e të paditurit për të paguar kamatën ligjore, gjykata vendosi konform nenit 277 të LMD-së, pasi që i padituri është vonuar në pagesën e detyrimit ndaj paditëses dhe ka pranuar si moment të llogaritjes së kamatës datën e parashtrimit të padisë(09.06.2015) në këtë gjykatë.

Gjykata kishte parasysh pretendimin e të autorizuarës së të paditurit kur ka theksuar se lënda është vjetërsuar, por pas shikimit të shkresave të lëndës, vërtetoi se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me parashkrim, ngase sipas fletëtransferit të datës 26.03.2015, paditësja në emër të shkaktimit të dëmit nga i padituri në aksidentin e trafikut të datës 16.02.2008, i ka kompensuar të dëmtuarve shumën prej 15,539.79€, në llogarinë e përmbaruesit privat E.M, ndërsa padinë kundër të paditurit për regres e ka parashtruar me datë 29.06.2015. Andaj në bazë të dispozitës nga neni 380 të LMD-së, kërkesat e tilla parashkruhen në afat 3 vjeçar, ndërsa afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë nga dita kur paditësja e ka dëmshpërblyer palën e dëmtuar, e që rrjedhimisht në këtë rast nuk është tejkalluar ky afat.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale është marr konform dispozitës se nenit 449 dhe 452 të LPK-së, gjë që ka të bëjë me taksën gjyqësore në shumë prej 77.69€.

Nga arsyet e theksuara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Glllogoc
C.nr.112/23 me dt.11.04.2024**

**G j y q t a r i
Jeton Krasniqi**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.